**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori

# V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e parë e Qeverisë.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***


Nr. 02/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet Rregullorja për departamentet për integrim evropian dhe koordinim të politikave në kuadër të ministrive.

2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe të gjitha ministritë për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori:

# V E N D I M

1. Miratohet Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e procedurave pas bartjes së përgjegjësive të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin komunal.

2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të gjitha institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori:

# V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrit të Punëve të Brendshme për themelimin e Njësisë për Bashkëpunim Ndërkombëtare në zbatim të Ligjit ( ILECU)

2. Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtare në Zbatim të Ligjit do të themelohet në kuadër të Policisë së Kosovës, e cila do të përfshihet ne strukturën e brendshme organizative të policisë së Kosovës.

3. Detyrat dhe përgjegjësit e Njësisë do të caktohen me akt të brendshme në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

4. Me qëllim të Koordinimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar brenda kësaj Njësie një marrëveshje e bashkëpunimit do të nënshkruhet nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Prokuroria e Shtetit.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori:

## V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme për hartimin e agjendës lobuese për shtimin e njohjeve të Republikës së Kosovës.

2. Ministria e Punëve të Jashtme cakton grupin punues qeveritar për hartimin e agjendës lobuese për shtimin e numrit të njohjeve, në përbërje të përfaqësuesve të Ministrive, përcaktuar sipas pikës 3. të këtij vendimi, shoqërisë civile dhe personaliteteve me ndikim.

3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integrimit Evropian, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme për hartimin e strategjisë për politikë të jashtme të Republikës së Kosovës.

2. Ministria e Punëve të Jashtme cakton grupin punues qeveritar për hartimin e strategjisë për politikë të jashtme, në përbërje të përfaqësuesve të Ministrive të përcaktuara sipas pikës 3. të këtij vendimi.

3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria për Integrim Evropian, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9.2 të Ligjit për Ndërmarjet Publike dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori:

## V E N D I M

1. Ndryshohet Vendimi 02/41 datë 23.10.2008 për themelimin e Komisionit Ndërministror që të analizojë opsinnet për participimin e sektorit privat në PTK Sh.A duke përfshi edhe privatizimin eventual të të gjitha apo disa njësive të biznesit të PTK Sh.A.

2. Komisioni përbehet nga:

| | | |
|---|---|---|
| 1.1 | Z. Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, | Kryesues; |
| 1.2 | Znj. Mimoza Kusari Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë, | anëtare; |
| 1.3 | Z. Fehmi Mujota, Ministër i Infrastrukturës, | anëtar; |
| 1.4 | Z. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, | anëtar; |
| 1.5 | Z. Bedri Hamza, Ministër i Financave, | anëtar; |

3. Komisioni Qeveritar të ndjekë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese ne përputhje me kushtet procedurale të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me standardet më të larta ndërkombëtare.

4. Komisioni do t`i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës opsionet e mundshme të (privatizimit eventual ) të PTK-së sh.a.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori

### V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në shumën prej 40,000.00 (dyzetmijë) euro për organizimin e aktiviteteve, me rastin e shënimit të manifestimin gjithë-popullor "Epopeja e UÇK-ës.

2. Manifestimi gjithë-popullor "Epopeja e UÇK-ës", 2011, organizohet nën patronazhin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, kodi 104-10700 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.

4. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 09/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 dhe 13 të Ligjit nr. 03/L-065 për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, nenin 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2010 për kategorizimin e pikave te kalimit kufitar si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori:

## V E N D I M

1. Rikategorizohet pika e kalimit kufitar me Republikën e Maqedonisë "Stançiç", nga vendkalimi kufitar lokal në vendkalim kufitar rajonal për qëllime të komunikacionit ndërkombëtarë, përkatësisht kalon në kategorinë A.

2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme për njoftimin e autoriteteve relevante të Republikës së Maqedonisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/02
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori:

## V E N D I M

1. Të iniciohet procedura për hartimin e politikave për vendosjen e regjimit të vizave në Republikën e Kosovës.

2. Bartëse e këtij procesi caktohet Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë